



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 42.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-17-043-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-3202, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore më dt. 02.04.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 42, paragrafi 42.1 i KPK përcakton se "Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën"

Neni 38, paragrafi 38.1 i KPK përcakton se: "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

Me dt.28.03.2025, Menaxheri i kontratës, përmes e-mailit i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shpëputjen me marrëveshje të kontratës "Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës", e lidhur me dt.22.02.2018, me numër identifikimi : 632-17-043-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-3202.

Sipas Menaxherit të kontratës, në vitin 2020 dhe 2021, pandemia globale COVID-19, shkaktoi vonesa të papritura dhe të pakontrollueshme në realizimin e projekteve publike. Prandaj për shkak të pandemisë dhe luftimeve tjera, ngjarje këto që shkaktojnë krizë globale ku edhe çmimet e lëndës së parë pësuan ndryshime të mëdha, pamundësuan realizimin e kontratës për pjesën e mbetur.

Andaj, bazuar në nenin 42, paragrafi 42.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.28.03.2025, të menaxherit të kontratës, palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 22.02.2018, me numër identifikimi : 632-17-043-511 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-3202, me titull “Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve N.N.Sh.”Korben” & “King Holding” sh.p.k. – Gjakovë, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 03.04.2025.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherëve të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

për Xhoferi
Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



GJAKOVA
Komuna Gjakovë
Opština Gjakovica
Municipal of Gjakova

DATË:	21.03. 2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport, znj. Adea Roka
CC:	AL- Engineering, Prishtinë; Valdrin Zenuni – Ornani Mbikqyres z. Ndue Komani- OE
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	Menaxheri i Projektit – Rexhë Rexha 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shkëputjen me marrveshje te kontratës me titull: Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës " me nr. identifikimi 632-17-043-511, K Gjakovë

Operatori Ekonomik "Roza Komani BI" N.N.SH." KORBEN' Gjakovë ka paraqitur kërkesën Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sport me datën 21.03.2025 që të bëhet me mirëkuptim shkëputja e kontratës me titull: Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës " me nr. identifikimi 632-17-043-511, K Gjakovë.

Punimet kanë filluar 22.02.2018, punëkrysi ka ngritur shqetësimin se mosrealizimi i kësaj kontrate ka qenë COVID – 2019 (vitet 2020 – 2021) si dhe luftërat tjera ku te gjitha ngjarjet u shndërruan ne krizë globale ku dhe çmimet e lëndës së parë pësuan ndryshime të mëdha, andaj duke u bazuar në kontratë neni 38 " Forca Madhore" si pasojë e këtyre arsyeve të lartcekura:

Kërkoj si te behet ndërprerja e kontratës me titull ne mënyrë miqësore ne mes te Operatorit Ekonomik Korben dhe Komunës se Gjakovës për kontratën me titull: Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës " me nr. identifikimi 632-17-043-511, K Gjakovë.

Menaxheri i Projektit – Rexhë Rexha _____



Kësaj shkrese ja bashkëngjis :

- Kerkesën e kompanisë
- Paramasa dhe parallogaria – prerja e punimeve

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.1 PUNËT PARAPREGADITORE		Punet e Kontraktuara			
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.1.05	Pas përfundimit të punimeve të gjitha ndërtimet e përkohshme duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit si dhe terreni rreth objektit.	komplet	1.00	2.500.00	2.500.00
TOTAL POZICIONI				1.1	2.500.00
1.5 PUNËT E MURATIMIT					
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.5.05	Furnizimi me material dhe vazhdimi i oxhakut të nxemjes qendrore deri mbi kulm për së paku 60 cm me elemente të parafabrikuara të prodhuesit Schiedel. Vazhdimi duhet të bëhet me oxhak metalik me termoizolim dhe dy mure llamarine, tipi ICS i mveshur me inox, me diametër të brendshëm Ø300 mm dhe diametër të jashtëm Ø350 mm. Në çmim të përfshihen të gjitha kthesat e nevojshme për devijimin e kanalit dhe koka/kapela e gjerë e hapur për mbrojtje nga depërtimi i shiut si dhe elementet tjera të nevojshme për kalim adekuat nga kanali i muratur në kanalin nga llamarina. Për më shumë të dhëna shih përshkrimin teknik.	m ^l	10.0	370.00	3,700.00
TOTAL POZICIONI				1.5	3,700.00
1.7 PUNËT E NGJYROSJES					
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.7.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të palinuar dhe plafoneve të lëshuara të realizuara me pllaka gjips-kartoni me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastrimit si StoColor Puran. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyerje bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjytjes, etj. Për më shumë të dhëna rreth ngjyrave dhe aplikimit të tyre shih përshkrimin teknik dhe broshurat e materialeve.	m ²	2984.0	3.00	8,952.00
1.7.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve të suvatuara dhe pjesëve të plafoneve të realizuara me pllaka gjips-kartoni me dy shtresa ngjyrë StoColor In. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjytjes, etj. Ngjyra StoColor In aplikohet për hapësirat komunikuese si koridore, kafazet e shkallëve, kthinat teknike dhe ato ndihmëse si depo, etj. Për më shumë të dhëna rreth ngjyrave dhe aplikimit të tyre shih përshkrimin teknik dhe broshurat e materialeve.	m ²	1733.0	2.00	3,466.00
TOTAL POZICIONI				1.7	12,418.00
1.11 PUNËT E DYSHEMËSË					
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH

1.11.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë me laminat adekuat për hapësira publike si laminati i prodhuesit KRONO - nga seria Floordreams Vario, tipi Aquastop 12 mm me klikim të ashtuquajtur "1 clic2go" me nënshtrësën adekuate zëabsorbuese nga PE me trashësi 5 mm. Laminati i fillë ka shtrësën finale joulëlëshuese, antibakteriale dhe rezistente ndaj mikro-gërvishtjeve, me klasë R9 kundër rrëshqitjes dhe i takon klasit "Class 33 / AC 5" i destinuar për shfrytëzim intensiv në objekte komerciale. Tehet e laminatit të thyera në formë të shkronjës "V". Ngjyra dhe tekstura si dhe shkalla e shkëlqimit të laminatit të përzgjidhet nga organi mbikqyrës. Në çmim duhet të përfshihen elementet përcjellëse si rozetat/unazat nga druri për tubat që depërtojnë dyshemenë, listella e cokllës nga druri si tipi K70 me dimensione 21x70 mm ndërsa për fugat e dilatimit dhe për kapërcimin e fugave dhe disniveleve duhet të përdoren profilet kaluese dhe ato në formë rampash.	m ²	140.0	18.00	2,520.00
1.11.02	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së skenës me parket të bungut klasit të parë me trashësi 20 mm. Në çmim duhet të përfshihet ngjitja me ngjitës adekuat, gërryerja dhe lëmimi i parketit, mbrojtja me dy shtresa llak adekuat si dhe elementet tjera përcjellëse, listella e cokllës nga druri si tipi K70 me dimensione 21x70 mm ndërsa për fugat e dilatimit ndërsa për kapërcimin e fugave dhe disniveleve duhet të përdoren profilet kaluese dhe ato në formë rampash.	m ²	81.0	48.00	3,888.00
1.11.03	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së sallës koncertale dhe hapësirave tjera të përcaktuara me projekt me tepison adekuat për objekte publike me frekuentim intensiv si tepisoni i prodhuesit Sintelon nga Serbia, seria MATRIX, me trashësi totale 5.7 mm, me bazë të poshtme nga fije të thurura sintetike dhe karakteristika tjera të dhëna nga prodhuesi si në përshkrimin teknik. Në çmim duhet të përfshihet trajtimi paraprak të bazamentit për eliminimin e të metave të mundshme, lysterja me bazë/primer adekuat, aplikimi i masës rrafshuese vetnivelezuere, masa adekuate ngjitëse dhe finalizimi me të gjitha tipet e nevojshme të listellave këndore për mbrojtjen dhe ngjitjen e tepisonit duke ju përmbajtur në tërësi udhëzimeve të prodhuesit në lidhje me mënyrën e ngjitjes.	m ²	855.0	20.00	17,100.00
TOTAL POZICIONI				1.11	23,508.00
1.12	PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT				
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.12.02	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së kthineve të përcaktuara me projekt me pllaka të paglazura qeramike me dimensione 60x60cm, me ngjyrë dhe teksturë të përcaktuar nga organi mbikqyrës. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sonitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25. Për më shumë informata shih përshkrimin teknik.	m ²	255.0	29.00	7,395.00

1.12.04	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave të granilit si pikore të dritareve, pllaka parapeti, etj. Pllakat duhet të ngjiten me ngjitës adekuat për granit. Pikoret duhet të kenë kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drejtimet e padëshiruara të gahendura në anën e poshtme si dhe paralelisht me vijën e shpaletave. Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shiritë ekspandues hidroizolues për të parandaluar plasatën dhe dëmtimin e fasadës ndërsa në enterier të përdoret silikon sanitar. Pllakat e pikoreve duhet të mbështeten mbi mbajtës konzollë me ndërprerje termike të ankeruar në çdo 50 cm. Për më shumë të dhëna shih përshkrimin teknik. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të				
a.	Pllaka të granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 15 cm për pikoret mbi kornizat e dritareve.	m ^l	66.0	30.00	1,980.00
b.	Pllaka të granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 25 cm për pikoret e gjera të dritareve.	m ^l	51.0	40.00	2,040.00
c.	Pllaka të granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 16 cm për pikoret e ngushta të dritareve.	m ^l	97.5	30.00	2,925.00
d.	Pllaka të granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 22 cm për parapetin e dritareve.	m ^l	40.0	20.00	800.00
1.12.05	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme me pllaka graniti të poliruar Shkelëset - 35.0 x 135 cm dhe trashësi 3 cm Balloret - 13.5 x 135 cm dhe trashësi 2 cm Basamaku në pushimore të vazhdohet në tërë gjatësinë e pushimores. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	48.0	65.00	3,120.00
1.12.06	Furnizimi me material dhe mveshja e pushimorëve të shkallëve të brendshme dhe dyshemesë në të gjitha hapësirat e përcaktuara me projekt me pllaka graniti të poliruar me trashësi 2 cm duke përfshirë edhe punimin e cokllës nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjitja të bëhet me ngjitës adekuat për granit. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	585.0	50.00	29,250.00
1.12.07	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme të hyrjet kryesore dhe hyrja e personelit me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar. Shkelëset - gjerësi 35 cm dhe trashësi 3 cm Balloret - lartësi 12 cm dhe trashësi 2 cm Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ^l	335.0	60.00	20,100.00
1.12.08	Furnizimi me material dhe mveshja e terasës para bifësë, e pushimorëve të shkallëve të jashtme para hyrjeve kryesore dhe rampave/pjerrinave për personat me aftësi të kufizuara me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar me trashësi 2 cm. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	376.0	52.00	19,552.00
1.12.09	Furnizimi me material dhe mveshja e platosë së ngritur para pllakës përkujtimore duke përfshirë edhe cokllën me lartë 10 cm si dhe mveshjen e bazës kubike ku do të vendoset pllaka përkujtimore me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar me trashësi 2 cm. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	30.0	52.00	1,560.00
TOTAL POZICIONI			1.12	88.722.00	

1.13 PUNËT E ZDRUKHTARISË					
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.13.03	Furnizimi dhe montimi i dyerve sipas specifikimeve në projekt. Materiali: ALUMIL ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Sistemi: M9400, profil me gjerësi 45 mm pa ndërprerje të urës termike. Korniza fikse: M9576 Krahu i derës: M9572 hapja brenda Krahu i derës: M9527 hapja jashtë Profili i mesëm lëvizës: M9504 Listella e kornizës: M9565 Listella e krahut: M9565 Adaptuesi i kahjes: M9374 Parapeti i dyerve: M9533 Profili i mesëm "T": M9548 Qelqi: Transparent/Termopan 4+14+4mm/Low-E + Argon Dorëzat: Inox Ngjyra: E bardhë - RAL 9016 Matt.				
b.	POS P - Panel ndarës me mbushje termoizoluese Dimensionet: 190x200 cm. Shih skemën A-66.	copë	1.0	1,700.00	1,700.00
1.13.06	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme të veshura me llamarinë çeliku. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: OIT - panel nga ashklat e drurit me trashësi 40 mm i veshur me llamarinë 0.8 mm. Korniza e derës: dypjesëshe - profili 21180 me trashësi 1.5 mm (opcionale - profili teleskopik 21168) Profili i mesëm: çelik - tipi 41102 Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak në formë rozete Mënteshat: tipi VX - 3 pjesësh me ngjyrë kromi mat Ngjyra: E bardhë - Traffic White RAL 7016.				
b.	POS 2 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 87.5x200 cm. Dizajni si në skemën e zdrukhtarisë A-54.	copë	11.0	350.00	3,850.00
e.	POS 5 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 100x200 cm. Dizajni si në skemën e zdrukhtarisë A-57.	copë	2.0	450.00	900.00
1.13.07	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme për shumë qëllime të veshura me llamarinë çeliku. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: H3D Multi Purpose Door me mbushje nga lesi mineral - me trashësi 45 mm, i veshur me llamarinë çeliku dhe i përforcuar me shufra çeliku dhe kunja sigurie. Korniza e derës: dypjesëshe e kombinuar - nga korniza këndore me ankerë dhe diplla dhe kontra-kornizë Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak standard të zgjatur vertikal dhe profil për cilindër Mënteshat: 3 pjesësh për pesha të mëdha Ngjyra: E bardhë - Grey White RAL 9002. Mbyllësi hidraulik: Standard				
a.	POS 6 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 100x200 cm. Dizajni si në skemën e zdrukhtarisë A-58.	copë	1.0	450.00	450.00
a.	POS Z1 - Derë dykrahëshe Dimensionet: 200x200 cm. Dizajni si në skemën e zdrukhtarisë A-59.	copë	2.0	1,250.00	2,500.00
b.	POS 6 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 100x200 cm. Dizajni si në skemën e zdrukhtarisë A-60.	copë	2.0	550.00	1,100.00
1.13.09	Furnizimi dhe montimi i njësive të parafabrikuara me dyer dhe panele ndarëse për kabinat e WC-ve dhe kthinave të pisoarëve të punuara nga HPL laminati dhe këmbë me lartësi të ndryshueshme. Materiali: Laminex - Austria ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: Laminex Multipurpose Compact - 13 mm HPL (High Pressure Laminate) rezistent ndaj gërvishjeve, ngjyrës, goditjeve, thyrjeve dhe lagështisë. Ngjyra: E hirtë - Oyster Grey White				
a.	POS TP1 - Njësia e përbërë nga 2 WC kabina Dimensionet totale: 180x150x202 cm. Dizajni si në skemën e zdrukhtarisë A-67.	njësi	2.0	1,025.00	2,050.00

b.	POS TP2 - Njësia e përbërë nga 5 WC kabina Dimensionet totale: 400x150x202 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë A-68.	njësi	2.0	1,750.00	3,500.00
c.	POS TP3 - Njësia e përbërë nga 2 WC kabina dhe kthina për pisaar. Dimensionet totale: 400x150x202 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë A-69.	njësi	2.0	1,250.00	2,500.00
TOTAL POZICIONI				1.13	18,550.00

1.14 PUNËT E FASADËS					
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.14.03	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës termoizoluese të tipit StoTherm Vario me finalizim nga pllakat e klinkerit nga prodhuesit e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Sistemi StoTherm Vario me pllaka klinkeri duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Ngjitës - StoLevell Uni • Termoizolim - EPS Top 31 Grafitt N3 - t=10cm • Rrjetë Armimi - Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese - StoLevell Uni • Ngjitës për pllaka - StoColl FM-S • Pllaka klinkeri - StoBrick Sandig 400x71x14 mm Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si pllakat në formë të shkronjës "L" për ekzekutimin e këndeve, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rëndelat termoizoluese, listelat dilatuese (anputzleiste) për dritare dhe dyer, shiritat ekspandues hidroizolues, mbajtësit konzollë për dritare dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	200.0	32.00	6,400.00
TOTAL POZICIONI				1.14	6,400.00

1.15 PUNËT E PLAFONIT DHE MVESHJES ME PLLAKA GJIPSKARTONI DHE PANELE KOMPOZITE					
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.15.01	Furnizimi me material dhe punimi i plafonit të lëshuar me pllaka modulare 60x60 të prodhuesit "Armstrong" ose ndonjë prodhuesi tjetër duke përfshirë konstruksionin metalik të tipit Armstrong Prelude 24 TLX me mbajtës primar dhe sekondar dhe varëse të tipit "Quickhanger". Pllakat janë me përbërje të ndryshme në varësi të destinimit të kthinës dhe mund të jenë me përbërje minerale, zëapsorbuese dhe metalike. Në pjesë të caktuara bordurat me gjerësi të ndryshme nga pllakat e gjips-kartonit do të ngjiten në konstruksion metalik të të njëjtit tip. Ngjyra e pllakave dhe konstruksionit duhet të jetë RAL 9010 (Standard White). Për më shumë informata shih detalet në projekt. Në vazhdim janë dhënë sasi të materialeve të zbërthyera sipas llojit.				
a.	Konstruksioni metalik Armstrong Prelude 24 TLX me mbajtësit kryesor dhe sekondar, me varëse të tipit "Quickhanger" duke përfshirë të gjitha mjetet lidhëse të nevojshme si tipila, lidhëse këndore, dhe elemente lidhëse për fiksion në profilin perimetrik, etj.	m ²	530.0	25.00	13,250.00
b.	Profil perimetrik për plafon nga pllakat modulare - AXIOM PERIMETER - SHADOWLINE PERIMETER BPT 3248 duke përfshirë fiksionin me vida në çdo 40 cm.	m ^l	651.0	30.00	19,530.00
c.	Profil perimetrik për bordurën e plafonit nga pllakat e gjipskartonit - AXIOM PERIMETER - PLASTERBOARD TRIM T3225 duke përfshirë fiksionin me vida në çdo 40 cm.	m ^l	122.0	38.00	4,636.00
d.	Profil i mesëm ndërlidhës për pjesën ku kalohet nga pllakat modulare në bordurat e gjipskartonit - AXIOM TRANSITION BPT3208.	m ^l	297.0	30.00	8,910.00
f.	Pllaka modulare me përbërje minerale zëapsorbuese - Ultima +dB - tipi Tegular 8 - 7695 M - 600x600x19 mm. Sasia - 135 copë.	m ²	48.6	45.00	2,187.00

g.	Pllaka metalike të perforuara Orcal Extra Microperforated Rg0701 - tipi Tëgular 8 - 600x600x8,5 mm Sasia - 1100 copë.	m ²	396.0	9.00	3,564.00
h.	Bardura rreth plafoneve të tipit Armstrong të punuara nga pllakat e gjipskartonit KNAUF - Platte A - EN520 12.5 mm duke përfshirë fiksimin me vida vetfletuese, mbushjen e fugave, bandazhimin dhe finalizimin e tërësishëm me një shtresë glet-masë. Pllakat ngjiten në konstruksionin e përshkruar në pikën 15.1.a	m ²	82.0	25.00	2,050.00
1.15.02	Furnizimi me material dhe punimi i plafonit të lëshuar nga pllakat e gjipskartonit KNAUF - Platte A - EN520 12.5 mm duke përfshirë mbushjen e fugave, bandazhimin dhe patinimin e tërë sipërfaqes me një shtresë gletë masë si dhe konstruksionin bartës metalik primar dhe sekondar i tipit D1 12 nga profilet CD 6x27, profilet perimetrike UD 28x27, lidhëset kryqë për profile CD dhe varëse metalike të tipit "nonius" si në detalet në projekt.	m ²	80.0	28.00	2,240.00
1.15.03	Furnizimi me material, mvëshja dhe modelimi i mureve në forma të thyera sipas projektit për reflektimin e zërit në sallën koncertale nga pllakat/panelet e dedikuara për mure dhe plafone me trashësi 10 mm, rezistuese ndaj lagështisë, rezistuese ndaj nxehtësisë së llampave, me sipërfaqe që mirëmbahet dhe pastrohet lehtë si KRONO Wall and Ceiling Panel - tipi XL Panel - Zero Joint me dimensione 2600x325 mm dhe konstruksionin bartës metalik me CW profile me trashësi 50 mm në distancat e rekomanduara nga prodhuesi i paneleve me mbushje nga leshti mineral i presuar me trashësi min.5 cm dhe të gjitha elementet tjera të nevojshme si mjetet lidhëse dhe listelat e formave të ndryshme për mbylljen e këndeve të brendshme dhe të jashtme. Vërejtje: Në sipërfaqen e llogaritur nuk janë marrë parasysh thyerjet.	m ²	532.0	170.00	90,440.00
1.15.04	Furnizimi me material, mvëshja dhe modelimi i plafonit të lëshuar në forma të thyera sipas projektit për reflektimin e zërit në sallën koncertale nga pllakat/panelet e dedikuara për mure dhe plafone me trashësi 10 mm, rezistuese ndaj lagështisë, rezistuese ndaj nxehtësisë së llampave, me sipërfaqe që mirëmbahet dhe pastrohet lehtë si KRONO Wall and Ceiling Panel - tipi XL Panel - Zero Joint me dimensione 2600x325 mm dhe konstruksionin bartës metalik me CW profile me trashësi 50 mm në distancat e rekomanduara nga prodhuesi i paneleve me mbushje nga leshti mineral i presuar me trashësi min.5 cm dhe të gjitha elementet tjera të nevojshme si mjetet lidhëse, varëset e tipeve të ndryshme dhe listelat e formave të ndryshme për mbylljen e këndeve të brendshme dhe të jashtme.	m ²	320.0	19.00	6,080.00
1.15.04	Furnizimi me material dhe punimi i plafonit të lëshuar në forma të thyera sipas projektit për apsorbimin e zërit në sallën koncertale nga pllakat e perforuara të gjipskartonit duke përfshirë mbushjen e fugave, bandazhimin, elementet tjera lidhëse dhe listelat e formave të ndryshme për mbylljen e këndeve të brendshme dhe të jashtme "KNAUF" - Cleaneo Acoustic - Seamless 8/18. Dimensionet e pllakës: 1188x1998 mm - 9.9kg/m ² - FF Material Number 94397 Në çmim duhet të përfshihen edhe: Nënkonstruksioni metalik - Profile MF - 65 mm Mbushja me lesht mineral të presuar min.5 cm Ngjyra: E bardhë - RAL 9010	m ²	160.0	24.00	3,840.00

1.15.05	Furnizimi me material, mveshja dhe modelimi i mureve në forma të thyera sipas projektit për opsorbimin e zërit në sallën koncertale të punuara nga pllakat e perforuara të gjipskartonit duke përfshirë mbushjen e fugave, bandazhimin, elementet tjera lidhëse dhe listellat e formave të ndryshme për mbylljen e këndeve të brendshme dhe të jashtme. "KNAUF" - Cleaneo Acoustic - Seamless 8/18. Dimensionet e pllakës: 1188x1998 mm - 9.9kg/m² - FF Material Number 94397 Në çmim duhet të përfshihen edhe: Nënkonstruksioni metalik - Profile MF - 65 mm Mbushja me lesh mineral të presuar min.5 cm Ngjyra: E bardhë - RAL 9010 Vërejtje: Në sipërfaqen e llogaritur nuk janë marrë parasyshtyerjet.	m²	240.0	21.00	5,040.00
1.15.07	Furnizimi me material dhe mveshja dekorative e shtyllave në sallën e ushtrimeve dhe në faqeun e sallës koncertale me panele kompozite të tipit ALUCOBOND Sunrise Silver Metallic pa shkëlqim duke përfshirë nënkonstruksionin metalik dhe të gjitha elementet tjera të nevojshme. Mveshja e shtyllave katrore duhet të bëhet me segmente gjysmë rrethore me lartësi 50 cm.	m²	37.5	60.00	2,250.00
TOTAL POZICIONI				1.15	164,017.00
1.16	PUNËT E METALIT				
POS	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.16.02	Furnizimi me material dhe punimi i gardhit të shkallëve të brendshme sipas detaleve në projekt me profile inoksi 50x50x3 mm të ankeruara në anën e epërme të basamakëve me anë të pllakës së inoksit me dimensione 120x100x5 mm me katër bulona me tipila ankerimi. Mbatjesit kryesor montohen në çdo 60 cm respektivisht në çdo të dytin basamak. Dorëza e gardhit punohet nga tubi i inoksit Ø 50x3 mm të lidhur me mbatjesit kryesor me shufër inoksi Ø 15 mm ndërsa mbushja bëhet me shufra Ø 15 mm në çdo 12 cm ndërsa në shtylla lidhen përmes pjesëve të salduara dhe të perforuara cilindrike për përshtatjen e pjerrësisë. Lartësia e gardhit 90 cm.	m ^l	20.0	120.00	2,400.00
1.16.03	Furnizimi me material dhe montimi i dorëzës metalike të rampave për personat me aftësi të kufizuara sipas detaleve në projekt me profile inoksi Ø 50 mm/3mm në lartësi 90 cm paralelisht me rampën, sipas detalit të paraqitur në projekt, dhe të ankeruara në mure me anë të pllakave të inoksit në formë rozetash dhe me bulona ankerimi.	m ^l	30.0	90.00	2,700.00
1.16.06	Furnizimi me material dhe montimi i profileve speciale kompozite për fugën e dilatimit në dysheme në enterier dhe eksterier para hyrjeve kryesore si lipi DSM FP - Deck to Deck - Split Slab Extension Joint i prodhuesit EMSEAL ose ndonjë profil i ngjashëm i prodhuesve tjerë për fuga me gjerësi 5 cm dhe lartësi të dyshemesë 10 cm. Profili me materialet përbërëse duhet të jetë rezistent ndaj zjarrit, depërtimit të lagështisë, depërtimit të zhurmës, rezistent nga goditjeve mekanike, opsorbues i vibrimeve, etj. Për më shumë të dhëna shih broshurën në seksionin e Broshurave dhe Listave Teknike.	m ^l	26.0	30.00	780.00
TOTAL POZICIONI				1.16	5,880.00

1.17 PUNËT E NDRYSHME					
	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH
1.17.01	Furnizimi dhe montimi i ulëseve të spektatorëve në sallën koncertale në dy seksione me rradhitje zigzake dhe lartësi të ndryshme sipas projektit. Ulëset duhet të jenë të mbështjellura me tapacir tekstil të kualitetit të lartë, zjarrëqëndrues dhe që pastrohet lehtë. Pjesa e poshtme e ulëses duhet të palohet. Pjesa e pasme, këmbët dhe korniza bartëse e ulëseve duhet të jetë nga çeliku i mbrojtur me ngjyrë rezistente ndaj gërvishjeve. Gjerësia aksiale e ulëseve 55 cm. Gjerësia e mbështetësve për duar 8 cm. Lartësia e ulëseve 110 cm. Ngjyra e tapacirit dhe e pjesëve metalike të përcaktohet nga organi mbikqyrës duke pasqyruar ambientin dhe harmoninë e tërësishme në sallë.	copë	429.0	70.00	30,030.00
1.17.02	Furnizimi dhe montimi i gardhit nga qelqi transparent tek rendi i parë i ulëseve në seksionin e dytë të ulëseve. Gardhi nga qelqi i kalit 10+10 mm dhe lartësi totale 90 cm duhet të montohet në pjesën e epërme të konzollës para ulëseve me profilet nga alumini për ankim në dysheme, me kapak mbulues dekorativ dhe pa dorëz në pjesën e epërme për të mos penguar shikimin në drejtim të skenës si tipi M8200 i prodhuesit Alumil.	m ^l	11.7	125.00	1,462.50
1.17.03	Furnizimi me material dhe shtrimi i shtigjeve rreth objektit dhe platave para hyrjeve kryesore me kubëza nga betoni i presuar, me dimensione 10x20 cm dhe trashësi t=8 cm, me dizajn të kombinuar me kubëza me ngjyrë natyrale të betonit dhe ngjyrë të kuqe. Në çmim duhet të përfshihet ngjeshja e dheut, shtresa bazë nga rëra e imët me trashësi 20 cm, shtresa e zhavorit 0-31mm me trashësi 10 cm dhe shtresa zhavorit 4-8 mm me trashësi 5 cm, dhe finalizimi me mbushjen e fugave.	m ²	1330.0	18.00	23,940.00
1.17.05	Furnizimi dhe montimi i ulëseve publike në platolë para hyrjeve kryesore dhe tek sheshi në pjesën veriore në pozitat e përcaktuara me projekt. Bazamenti i ulëseve duhet të jetë nga betoni i cilësisë së lartë MB 45 që përfshihet me aditiv për vetkompaktësim ndërsa ulëset duhet të punohen nga druri i cilësisë së lartë i mbrojtur me ngjyrë adekuate. Dimensionet e ulëseve: 2140x450x500 mm	copë	32.0	125.00	4,000.00
1.17.06	Furnizimi dhe montimi i shportave të mbeturinave në platolë para hyrjeve kryesore dhe tek sheshi në pjesën veriore në pozitat e përcaktuara me projekt. Bazamenti statik duhet të jetë nga betoni i cilësisë së lartë MB 45 që përfshihet me aditiv për vetkompaktësim ndërsa enët/shportat e lëvizshme duhet të punohen nga llamarinë e zinkuar. Dimensionet e bazamentit nga betoni: ≈50x50x600 mm	copë	16.0	80.00	1,280.00
1.17.13	Furnizimi me material dhe rregullimi i pjesëve të parapara për gjelbrim duke përfshirë nivelizimin e dheut të ngjeshur, mbushjen me dhe kualitativ me trashësi së paku 30 cm, plehërimin, rrafshimin e sipërfaqes, mbjelljen me bar, lule dhe shkurre dekorative.	m ²	700.0	5.00	3,500.00
1.17.14	Furnizimi me mbjellja e drunjëve gjetherënës në pjesët e parapara me projekt. Lloji i drunjëve të përcaktohet nga organi mbikqyrës në konsultim me përfaqësuesin e investitorit.	copë	70.0	30.00	2,100.00
1.17.16	Furnizimi dhe montimi i grilave për pastrimin e këpucëve në dysheme para erëmbrojtësve të hyrjeve kryesore. Grilat duhet të jenë të prodhuesit Hagomat të tipit Combistrip Brush 24 with Mondial Bristle Strip me kornizën nga çeliku që nuk ndryshket të ankuar në dysheme. Madhësia e grilave 2.10x210 cm. Korniza nga çeliku - Stainless Steel Part no. 18 400	copë	4.0	328.00	1,312.00

1.17.17	Furnizimi dhe montimi i pllakave/tabelave me emërtime/orientime në hyrje të objektit, pllakat/tabelat me emërtime/orientime në hallët e përbashkëta dhe pllakëzat me emërtime të kthinave ku duhet të specifikohet numri i kthinës, destinimi i kthinës dhe emri i personelit. Pllakat duhet të punohen nga dy pllaka transparente nga pleksiglasë, secila me trashësi 5 mm në mes të të cilave ngjitet teksti i punuar në tapet vetngjithës. Dimensionimi i pllakave të kthinave 15x25 cm ndërsa pllakat tjera në varësi nga përmbajtja. Fiksimi në mur duhet të bëhet me elemente shtrënguese cilindrike nga inoksi me koka me vidë që mundëson largimin e lehtë të pllakave dhe zëvendësimin e tekstit të përshkruar si në seksionin e punëve të ndryshme në përshkrimin teknik.	paushall	1.0	1,500.00	1,500.00
1.17.18	Pastrimi i tërësishëm i objektit nga brenda dhe jashtë duke përfshirë edhe pastrimin e parterit dhe përgaditja për pranid-dorëzim të objektit. Në çmim duhet të përfshihet pastrimi i pluhurit, pastrimi i dritareve, dyerve, dyshemeve dhe nyjeve sanitare me mjete higjienike dhe dezinfektuese.	paushall	1.0	2,000.00	2,000.00
1.17.19	Aparat për fikjen e zjarrit me pluhur - 9 kg	copë	12.0	100.00	1,200.00
1.17.20	Aparat për fikjen e zjarrit me CO2 - 5 kg	copë	5.0	75.00	375.00
TOTAL POZICIONI				1.17	72,699.50

REKAPITULLIM - PUNËT NDËRTIMORE

01	PUNËT PARAPREGADITORE				2,500.00 €
05	PUNËT E MURATIMIT				3,700.00 €
07	PUNËT E NGJYROSJES				12,418.00 €
11	PUNËT E DYSHEMËSË				23,508.00 €
12	PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT				88,722.00 €
13	PUNËT E ZDRUKHTARISË				18,550.00 €
14	PUNËT E FASADËS				6,400.00 €
